

**VENDIM**  
**Nr.345, datë 20.5.2005**

**PËR DHËNIE LICENCE**

**PËR RADIO VENDORE PRIVATE “ARMONIA FM”**  
**SUBJEKTIT: SHOQËRIA “DROPULL” SH.P.K.**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë“, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë“ të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**VENDOSI:**

1. T’i japë shoqërisë “Dropull” sh.p.k., licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin Gjirokastër.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona mbulimet, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**